

KALLËZIM – PENAL

KALLËZUES: Monika Kryemadhi, në cilësinë e Kryetare e Partisë “Lëvizja Socialiste Për Integrim”, me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, nr. 20/10, Tiranë.

Ndaj:

1. Titullarit të Autoritetit Kontraktor, ish- Ministrit të Mjedisit, Z. Lefter Koka;
2. Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave Ëngjell Agaçi;
3. Ish Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit Z. Alqi Bllako;
4. Komisionit të Dhënies me Koncesion për projektin “Për Ndërtim Landfilli, Inceneratori dhe Rehabilitim i Venddepozitimeve Ekzistuese Tiranë dhe Prodbimin e Energjisë Elektrike”;

OBJEKTI:

1. Kallëzimi i veprave penale të:
“Shpërdorimit të Detyrës”, parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal;
“Shkelje të barazisë së pjesëmarrësve në tendera” parashikuar në nenin 258 të Kodit Penal;
“Fshehja e të ardhurave” parashikuar në nenin 180 të Kodit Penal;
“Mospagimi i Taksave”, parashikuar në nenin 181 të Kodit Penal;
“Moskryerja e detyrave nga organet Tatimore”, parashikuar në nenin 181/a të Kodit Penal;
“Përfitim i Paligjshëm i interesave”, parashikuar në nenin 257 të Kodit Penal;
“Korrupsioni pasiv i funksionarëve të Lartë Shtetërorë” ose të Zgjedhurve Vendorë”, parashikuar në nenin 260 të Kodit Penal;
“Pastrim i Produkteve të veprës penale”, parashikuar në nenin 287 të Kodit Penal;
“Moskallzim Krimi, parashikuar në nenin 300 të Kodit Penal.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
Neni 283 i Kodit të Procedurës Penale;
Nenet 180, 181, 181/a, 248, 257, 258, 260, 287, 300 të Kodit Penal;
Ligji nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publike Privat” i ndryshuar;
Ligji nr. 9643 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar,

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

DREJTUAR: 1. PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
2. STRUKTURËS SË POSAÇME ANTIKORRUPSION (SPAK) TIRANË

Të nderuar zonja/zotërinj Prokurorë,

I.LEGJITIMITETI:

1. Unë Kallzuesja Monika Kryemadhi, pasi kam ndjekur në vijimësi dhe me shumë shqetësim prej disa kohësh denoncimet publike lidhur me kontratën koncesionare të formës BOT (Ndërtim – Operim – Transferim) me objekt: “Për ndërtimin dhe administrimin e Impiantit të Administrimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Elbasan”, si dhe pasi jam vënë në dijeni të dokumenteve, fakteve e provave të kësaj afere, në cilësinë e personit që kam marrë dijeni për disa vepra penale, bazuar në nenet 283 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, paraqes këtë kallzim pranë Institucionit Tuaj duke parashtruar se:

2. Nga informacioni dhe dokumentacioni që jam vënë në dijeni, rezulton se:

a) Procedura e Koncesionit e formës BOT (ndërtim – operim – transferim) me objekt: “Për Ndërtimin dhe Administrimin e Impiantit të Administrimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Elbasan” është një projekt që financohet në masën 100% nga Shtetit Shqiptar (përfshirë dhe interesat bankare të shoqërisë koncesionare), pra nga taksapaguesit shqiptarë, do të realizohet dhe do të ketë një kohëzgjatje prej 7 vjetësh;

b) Ka indicie dhe dyshime të arsyeshme se veprimet dhe mosveprimet e Ish- Ministrit të Mjedisit Z. Lefter Koka, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave Ëngjëll Agaçi, Ish-Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit Z. Alqi Bllako dhe Komisionit të Dhënies me Koncesion të projektit koncesionar me objekt: “Për Ndërtimin dhe Administrimin e Impiantit të Administrimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Elbasan”, janë kryer në kundërshtim të plotë me Ligjin 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneriteti Publik Privat”, i ndryshuar dhe në kundërshtim të plotë me Ligjin 9643 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, duke krijuar kosto dhe pasoja shumë të rënda financiare dhe ligjore ndaj shtetit dhe shtesave shqiptarë. Gjithashtu, edhe veprimet e mëpasshme financiare të kryera nga shoqëria koncesionare dhe shoqëri e persona të lidhur ngushtë me Ish- Ministrin e Mjedisit Z. Lefter Koka, krijojnë dyshime të arsyeshme për konsumimin e një sërë vepra penale me karakter financiar dhe jo vetëm.

3. Pasi kam analizuar të gjithë dokumentacionin që disponoj, si dhe jam konsultuar me profesionistë të fushës përkatëse mjedisore, urbane juridike e financiare, Unë kallzuesja, vlerësoj se veprimet dhe mosveprimet e kryera nga personat e cituar në këtë kallzim, përbëjnë vepra penale.

4. Bazuar në nenet 283 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, po depozitoj këtë kallëzim penal përpara organit të akuzës me qëllim fillimin e hetimeve ndaj Ish Ministrit të Mjedisit Z. Lefter Koka, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave Ëngjëll Agaçi, Ish Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së

Mjedisit Z.Alqi Bllako dhe Komisionit të Dhënies me Koncesion, përgjegjës për procedurën e dhënies me Koncesion të Formës BOT (ndërtim – operim – transferim) me objekt: “Për Ndërtimin dhe Administrimin e Impiantit të Administrimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Elbasan”. Personat e kallzuar janë përgjegjës për veprat penale të parashikuara në nenet 180, 181, 181/a, 248, 257, 258, 260, 287, 300 të Kodit Penal, pasi rezulton se këto subjekte, përgjatë kryerjes së detyrës së tyre lidhur me koncesionin e sipërcituar, me dashje kanë shpërdoruar detyrën që kanë ushtruar.

II.RRETHANAT E ÇËSHTJES:

5. Në datë 04.07.2014, Bashkia Elbasan i ka dërguar kërkesë Ministrisë së Mjedisit, lidhur me projekt për trajtim mbetjesh.

6. Në datë 09.07.2014, Ministria e Mjedisit i kthen përgjigje Bashkisë Elbasan, ku shprehet se projekti përbën interes publik.

7. Në datë 11.08. 2014,Shoqëria “Albtek Energy”, sh.p.k., shoqëri e regjistruar në QKR në datë 14.07.2014, pa asnjë përvojë në fushën e trajtimit të mbetjeve dhe me kapital themeltar 100.000 lekë i paraqet Ministrisë së Mjedisit kërkesë për shprehje interesi për Koncesion/PPP për Impiantin e Përpunimit të Mbetjeve Elbasan, shoqëruar me një projekt paraprak në një material prej 25 faqe.

8. Në datë 18.09.2014, Bashkia Elbasan, me Vendimin nr. 70 datë 18.09.2014 ka shpallur Emergjencën Mjedisore për menaxhimin e mbetjeve në territorin e Bashkisë Elbasan dhe në datë 22.09.2014, ia ka përcjellë këtë vendim Ministrisë së Mjedisit.

9. Në datë 14.10.2014, Ministri i Mjedisit nxjerr urdhrin për ngritjen e Komisionit të Koncesionit;

10. Në datë 24.10.2014 shoqëria propozuese “Albtek Energy”, sh.p.k., i dërgon Ministrisë së Mjedisit dokumentacionin tekniko financiar dhe ofertën financiare të rishikuar. Referuar këtij dokumentacioni, rezulton se shoqëria propozuese ka ndryshuar ofertën e saj nga 22 mln euro investimi, që ishte parashikuar fillimisht, në vlerën 20 mln pa tvsh.

11. Në datë 27.10.2014, shoqëria propozuese “Albtek Energy”, sh.p.k., i paraqet Ministrisë së Mjedisit studimin teknik, të dhënat e të cilit do të përdoren më pas copy paste në DST.

12. Në datë 31.10.2014, Ministria e Mjedisit i kërkon Ministrisë së Financave miratim paraprak për financim.

13. Në datë 31.10.2014, Ministria e Mjedisit i dërkon kërkesë për mendim MZHETS.

14. Në datë 02.11.2014, miratohet VKM nr. 724 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, 2015-2017” ku rezulton se është shtuar në buxhet zëri i inceneratorëve.

15. Në datë 07.11.2014, Ministria e Financave i kthen përgjigje Ministrisë së Mjedisit duke refuzuar financimin e projektit.

16. Në datë 11.11.2014, Komisioni i Dhënies me Koncesion për projektin koncesionar me objekt: “Për Ndërtimin dhe Administrimin e Impiantit të Administrimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Elbasan” me anë të një proces-verbali, pasi ka arsyetuar situatën emergjente mjedisore në Bashkinë Elbasan, si dhe pasi ka

cituar në mënyrë të gabuar, në pikën 14 të procesverbalit se: Ligji 125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” e parashikon procedurën negociim pa shpallje, i ka propozuar Ministrin të Mjedisit që së bashku me Ministrin e MZHETS të hartojnë një projektvendim për mënyrën e përzgjedhjes “koncesion i përzier” sipas procedurës “me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” me subjektin “Albtek Energy” sh.p.k., mbështetur në pikën 3 të nenit 22 të Ligjit 125/2013, dhe në pikën 3 (referencë e gabuar ligjore) të nenit 33 të Ligjit “Për Prokurimit Publik” si dhe formën BOT të koncesionit dhe afatin prej 15 vitesh.

17. Procesverbali i hartuar në datë 11.11.2014, Komisioni i Dhënies me Koncesion, në faqen e parë ka shënimin “OK” dhe firmën e Ministrin të Mjedisit, Z. Lefter Koka.

18. Në datë 11.11.2014, Ministria e Mjedisit i ka dërguar: Ministrisë së Financave; Ministrisë së Drejtësisë; Ministrisë së energjisë dhe Industrisë, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Tregëtisë dhe Sipërmarrjes dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, projektvendimin (projekt vkm) për mendim me objekt: “Për Përcaktimin e Autoritetit Kontraktues përkatësisht Ministrinë e Mjedisit, për dhënien me koncesion/ppp të ndërtimit dhe administrimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan, për prodhimin e Energjisë elektrike”, për procedurën përzgjedhëse me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës që i jepet shoqërisë “Albtek Energy” sh.p.k., të hartuar nga Ministria e Mjedisit.

19. Në datë 13.11.2014, Ministria e Drejtësisë i ka kthyer përgjigje Ministrisë së Mjedisit, duke u shprehur parimisht dakord me iniciativën, por duke sqaruar se ky është akt nënligjor me karakter individual dhe si i tillë nuk mund të trajtohet nga Ministria e Drejtësisë.

20. Në datë 14.11.2014, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes i ka kthyer përgjigje Ministrisë së Mjedisit duke u shprehur parimisht dakord.

21. Në datë 17.11.2014, Ministria e Energjisë dhe Industrisë i ka kthyer përgjigje Ministrisë së Mjedisit duke u shprehur parimisht dakord.

22. Në datë 18.11.2014, Agjencia e Prokurimit Publik (*Institucionit Qendror Përgjegjës në vend për mbarëvajtjen e sistemit të prokurimit publik, koncesioneve/partneritetit publik privat dhe ankandit publik*), i ka kthyer përgjigje Ministrisë së Mjedisit duke sqaruar se:

Së pari referuar nenit 13, pika 2 të Ligjit 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” Ministria e Mjedisit është Autoritet Kontraktues, duke nënkuptuar se nuk ka nevojë për miratimin e një VKM-je dhe,

Së dyti, APP ka sqaruar se: Neni 22 pika 3 e Ligjit për Koncesionet parashikon llojet e procedurave që ndjek autoriteti kontraktues që janë: 1) procedurë e hapur; 2) procedurë e kufizuar dhe 3) procedurë negociim me shpallje paraprake të njoftimit, pra APP i ka bërë të qartë Ministrisë së Mjedisit se procedura e propozuar nga Ministri i Mjedisit, negociim pa shpallje, nuk parashikohet në Ligjin për Koncesionet. Gjithashtu, APP në vijim të përgjigjes ka vlerësuar dhe e ka sqaruar Ministrinë e Mjedisit se përcaktimi i Autoriteti Kontraktues (pra në rastin konkret Ministria e Mjedisit) dhe procedura përzgjedhëse për objektin konkret duhet bërë në përputhje me parashikimet ligjore.

23. Në datë 18.11.2014, Ministria e Mjedisit i ridërgon kërkesë Ministrisë së Financave për miratim studim fizibiliteti, duke i bashkëngjitur kësaj kërkesë dokumentacionin e hartuar nga Ministria e Mjedisit (studim fizibiliteti, plan biznesi etj).

24. Në datë 25.11.2014, Ministria e Financave i ka kthyer përgjigje refuzuese Ministrisë së Mjedisit, duke parashtruar disa komente lidhur me procedurën e përzgjedhur nga Autoriteti Kontraktues, si dhe lidhur me vlerësimin financiar të projektit.

25. Ministria e Mjedisit i ka dërguar edhe 3 kërkesa tjera Ministrisë së Financave për miratim e financimit dhe përkatësisht në datë 20.11.2014, në datë 03.12.2014 dhe në datë 10.12.2014.

26. Në datë 10.12.2014, Ministria e Financave, ka dhënë miratimin paraprak për mbështetjen financiare të projektit.

27. Në datë 12.12.2014, Ministri i Mjedisit i dërgon ftesë shoqërisë “Albtek Energy” sh.p.k., për të paraqitur ofertë brenda datës 16.12.2014, për dhënien me koncesion/ppp me objekt: “Për ndërtimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të qytetit të Elbasanit”. Bashkëngjitur kësaj ftese ndodhen dst, ku konstatohet se si kritere kualifikimi janë kriteret më minimale të mundshme pa parashikuar asnjë kriter teknik, profesional apo eksperiencë të ngjashme. Gjithashtu, kriteri i vetëm financiar i kërkuar nga Autoriteti Kontraktues është paraqitja e një dokumenti bankar në emër të shoqërisë që të vërtetohet se shoqëria disponon 10% të vlerës së investimit të përgjithshëm.

28. Në datë 16.12.2014, shoqëria “Albtek Energy” sh.p.k., ka paraqitur Formularin e ofertës së bashku me dokumentacionin kualifikues. Nga shqyrtimi i dokumentacionit kualifikues të paraqitur nga kjo shoqëri, konstatohet se as kriteri i vetëm financiar i kërkuar nga Autoriteti Kontraktues për vërtetimin bankar në masën 10 % të vlerës së investimit, nuk është përmbushur nga ofertuesi, pasi nuk është paraqitur asnjë dokument i tillë.

29. Në datë 16.12.2014, në ora 13.00 Komisioni i dhënies me Koncesion, pa u shprehur fare për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria propozuese, ka kaluar drejtpërdrejt në negociimin e kontratës dhe pasi ka firmosur draft kontratën, ka propozuar miratimin në Këshillin e Ministrave të saj.

30. Po në datë 16.12.2014 Kontrata është firmosur nga Ministri i Mjedisit dhe në datë 17.12.2014 i është dërguar propozimi Këshillit të Ministrave për miratimin e një VKM për dhënien e miratimit për sigurimin e financimit të nevojshëm të kontratës së koncesionit.

31. Në datë 17.12.2014 Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr. 907 “Për Dhënien e Miratimit për Sigurimin e Financimit të Nevojshëm të Kontratës së Koncesionit për Ndërtimin dhe Administrimin e Impiantit të Trajtimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut të Elbasanit dhe Prodhimin e Energjisë”. Gjithashtu, kjo VKM ngarkon për zbatimin e saj Ministrinë e Mjedisit dhe Ministrinë e Financave dhe parashikon hyrjen në fuqi të saj pas botimit në Fletoren zyrtare. Gjithashtu, rezulton se VKM është publikuar në Fletoren zyrtare në datë 06.01.2015 e për pasojë efektet juridike të saj prodhohen pas botimit të saj.

32. Në datë 18.12.2014, ende pa hyrë në fuqi VKM nr. 907 (pasi nuk ishte botuar në fletore zyrtare) që ka miratuar dhënien e miratimit për sigurimin e financimit të kësaj kontrate koncesionare, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit Z. Alqi Bllako i ka dërguar një kërkesë Kryetarit të Bashkisë Elbasan, për caktimin e sheshit ku do të ndërtohet Impianti i përpunimit të mbetjeve. Në këtë dokument, Z. Bllako ka cituar edhe vendimmarrjen e Këshillit të Ministrave për sigurimin e financimit, por nuk e ka cituar faktin se kjo VKM ende nuk kishte hyrë në fuqi.

33. Në datë 27.01.2015 Këshilli Kombëtar i Territorit të RSH, ka miratuar lejen e ndërtimit për Impiantin e Trajtimit të Mbetjeve të Qarkut Elbasan.

34. Punimet për ndërtimin e impiantit, sipas dokumentacionit të shoqërisë koncesionare, kanë nisur në datë 05.03.2015 ndërkohë që referuar dokumentacionit të dosjes rezulton se Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit e ka dërguar të zbardhur Vendimin nr.1 të KKT, të miratimit të lejes së ndërtimit në datë 11.03.2015 pra teorikisht 6 ditë pasi shoqëria kishte filluar ndërtimin.

35. Referuar dokumentacionit të dosjes rezulton se shoqëria koncesionare “Albtek Energy” në datë 31.10.2016 është pajisur me Liçencë për shitje Energjie nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë për një periudhë 25 – vjecare, ndërkohë që kohëzgjatja e koncesionit do të ishte vetëm 7 vjet. Rezulton se objekti koncesionar ka përfunduar në datë 30.12.2016.